



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Mëgjani p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 05.01.2018, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **Z. KUSHTRIM HYSENI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Bajram Mulaku**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Kushtrim Hyseni**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 03.01.2018, nr.01/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Bajram Mulaku, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Kushtrim Hyseni, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 05.01.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka